



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 4738 Prot.  
13

Pogradec, më 02.12. 2024

VENDIM

NR. 129, DATË 27.11. 2024

**MIRATIMI I RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES, SIPAS NENIT 53, PIKA 5, LIGJI 139/2015**

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi shqyrtoi me këshilltarët dhe miratoi propozimet e paraqitura si dhe pikat e rendit të ditës të njoftuara për vendimarrje në njoftimin për mbledhjen e datës 27.11.2024, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 54, gërma k, si dhe neni 97, pika 2 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr. 40, datë 05.03.2020.

**KËSHILLI I BASHKIAK**

**VENDOSI:**

1. Të miratojë rendin e ditës për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Pogradec me pikat si më poshtë:

**1.1 Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.

**1.2 Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 30.10.2024.

**1.3 Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjet e datës 30.10.2024.**

**1.4 Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Tetor 2024.

**1.5 Projekt – Vendim:** Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Pogradec ( faza II ).

**1.6 Projekt – Vendim:** Miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec.



*Handwritten signature*

**1.7 Projekt – Vendim:** Për miratimin e planit të përmirësimit të arsimit parashkollor 2025-2027 në Bashkinë Pogradec.

**1.8 Projekt – Vendim:** Për miratimin në parim të dhënies në përdorim, për ndërtim park fotovoltaik ( stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse), në pasuritë me sipërfaqe totale 47.4663 ( dyzet e shtatë presje katërmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjet e tre) ha.

**1.9 Projekt – Vendim:** Për një ndryshim në VKB-në nr. 105, datë 22/09/2022, “Për përcaktimin e procedurës për negocimin me zhvilluesit privat që shprehin interes të bashkëpunojnë me Bashkinë Pogradec, nëpërmjet marrëveshjes për pronat në pronësi të saj”.

**1.10 Projekt – Vendim:** Dhënien e bonusit të qerasë për z. Bujar Turtulla në Bashkinë Pogradec.

**1.11 Projekt – Vendim:** Dhënien e bonusit të qerasë për z. Edmond Alla në Bashkinë Pogradec.

**1.12 Projekt – Vendim:** Dhënien e bonusit të qerasë për z. Refat Bufi në Bashkinë Pogradec.

**1.13 Projekt – Vendim:** Mbi dhënie shpërblimi për nxënësit ekselentë që kanë përfunduar arsimin e mesëm në vitin shkollor 2023-2024.

**1.14 Projekt – Vendim:** Për dhënie ndihme financiare për znj. Erida Hoxha.

**1.15 Projekt – Vendim:** Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe planit të konsultimeve publike të Këshillit të Bashkisë Pogradec për vitin 2025.

**1.16 Projekt – Vendim:** Për miratimin e shpenzimeve nga buxheti i këshillit të Bashkisë Pogradec për vitin 2025.

**1.17 Ankesa-Kërkesa**

1. Kërkesë nga z. Seladin Capo, Kryetar i fshatit Gështenjas, për vënien e emrit të z. Arefi Tahir Yskollari ,shkollës 9-vjecare “Kajo Karafili” në fshatin Gështenjas .

2. Kërkesë nga Shoqata A.K “GORA”Pogradec, për të rivendosur pllakën e lapidarit me të njëjtin mbishkrim që ka pasur më parë tek Guri i Kamjes”



2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE E KËSHILLIT**

Manjola **KAMOLLI**



1. Miratuar me 20 vota

2. Vota Pro 20

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më datë 02.12.2024